

### SITUATA NË SHQIPËRI NË VITIN 1921\*

Raportet diplomatike janë një nga njësitë më të rëndësishme që përherë kanë përbërë lëndën esenciale në përvijimin e politikave, interesave, qëllimeve, qëndrimeve, strategjive dhe të marrëdhënieve që një shtet ndërton dhe përcakton në raport me të tjerët. Projektimi dhe hartimi i interesave parësore në politikën e jashtme të shteteve është sendërtuar nëpërmjet instrumenteve dhe institucioneve politike dhe diplomatike të brendshme dhe të jashtme. Këto të fundit shërbejnë dhe veprojnë jo vetëm si burime të mirëfillta informacioni, por edhe si deshifruese e njohëse për materialin që përgatisin për vendin dhe banorët e tij.

Italia si një nga fuqitë më të interesuara kundrejt Shqipërisë, pas Luftës së Parë Botërore ishte gjithmonë e prirur jo vetëm për të qenë e pranishme fizikisht në vend, por edhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm sa i takon zhvillimeve të ndryshme që ndodhnin në Shqipëri. Kjo i krijonte asaj mundësi të shumta që të organizonte, të përpilonte madje dhe të ndryshonte projektet dhe nismat e saj, me qëllim që diplomacia italiane të arrinte objektivat konkrete në këtë vend.

Këto projekte pasqyrohen gjerësisht në fondet e Arkivit Historik e Diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë në Romë. Ky fond dokumentesh është një nga oazet e çmuara për t'u hulumtuar dhe thelluar në të gjithë përmasat e shkakësisë dhe të kohësisë së ngjarjeve në procesin e shkrimit të historisë moderne të Shqipërisë. Aq më tepër kur vëren se në Ministrinë e Jashtme italiane gjatë gjysmës së parë të shek. XX, informacioni që ka qarkulluar, që është përpunuar, që është klasifikuar dhe që ka të bëjë me Shqipërinë ka pasur një intensitet dhe fluks të jashtëzakonshëm. Për shkak të detajeve, të të dhënave dhe gjithçmos ky fond arkivor merr një vlerë të vyer si për historiografët ashtu edhe për studiues të disiplinave dhe fushave të ndryshme.

Pjesë e këtij fondi është edhe raporti që po paraqesim më poshtë. Ai i përket serisë *Affari Politici Albania 1919-1930*, viti 1921, busta 700. Ky raport, që mban datën 10 mars 1921, është përgatitur dhe transmetuar nga konsullata e përgjithshme e Italisë në Janinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë. Titujt janë vendosur nga autori në përshtatje me përmbajtjen e informacionit që paraqet secila prej pjesëve të këtij raporti. Ai fillon me një hyrje të përgjithshme rreth gjendjes së Shqipërisë, ndërsa më pas pasqyron të dhëna për

---

\* Dokument i publikuar në Konferencën Shkencore “Kërkime të Reja në Institutet e Qendrës së Studimeve Albanologjike”, Tiranë, më 20 dhjetor 2012. D

krainën e Himarës. Në të bëhet fjalë edhe për procesin e zgjedhjes së senatorëve në Gjirokastrë dhe Korçë, shpjegohet gjendja, në të cilën ndodhet ushtria dhe xhandarmëria shqiptare dhe në fund ai informon mbi qëndrimin e institucioneve shtetërore shqiptare kundrejt ardhjes në vend të disa komisioneve të huaja për të parë sesi ishte gjendja në realitet.

**Sokol GJERMËNI**

Konsullata Mbretërore e Përgjithshme e Italisë në Janinë  
Nr. 99/20

Ministrisë së Punëve të Jashtme  
25248      10 Mars 1921

Objekti: Situata politike – ushtarake në Shqipëri

**Një vështrim i përgjithshëm**

Zoti ministër,

Në vijim të raportit tim Nr. 54/16 të 4 shkurtit, kam nderin t'i paraqes Shkëlqesisë Suaj sa vijon në lidhje me situatën politike dhe ushtarake në Shqipëri.

Sikurse e kam informuar Shkëlqesinë Tuaj me raportin e lartpërmendur, nacionalistët shqiptarë brenda partive të ndryshme që ekzistojnë në vend, janë marrë vesh ndërmjet tyre me qëllim që të shmangin dhënien e karakterit të një shteti të vogël mysliman Shqipërisë. Mënyra është që të shkaktojnë rrëzimin e qeverisë së Sulejman bej Delvinës, e cila po shfaq se ka një program që e paraqet Shqipërinë si një shtet fetar mysliman dhe të lidhur me atë të Kostandinopojës.

Prandaj emërimi i Iljaz bej Vrionit si kryeministër i qeverisë së Tiranës, u përshëndet me shumë entuziazëm nga të gjithë nacionalistët shqiptarë.

Për këta të fundit figura e Iljaz bej Vrionit përfaqësonte shfuqizimin e sistemit administrativ që kishte zbatuar Sulejman bej Delvina dhe një garanci për zhvillimin e Shqipërisë si një shtet i vërtetë, i pavarur dhe i lirë, megjithatë parashikimet e nacionalistëve nuk u provuan nga faktet.

Ndërmjet periudhës së shkurtër të kohës që kaloi, qeveria e Iljaz bej Vrionit që nga dita e ardhjes në fuqi e deri më sot, ka demonstruar faktikisht se ishte një qeveri e marrëveshjes, me program në favor të vendosjes së bashku të përfaqësuesve nga besimet e ndryshme.

Megjithatë e njëjta qeveri nuk kishte forcën e nevojshme për të luftuar zakonet e rrënjësura të së shkuarës dhe t'i jepte fund influencës që ishte krijuar në mjedisin shoqëror nga qeveria e mëparshme.

Ligjet osmane qëndrojnë akoma në fuqi. Batalionet e Korçës dhe të Gjirokastrës janë formuar vetëm me myslimanë. Zyrat publike, veçanërisht ato më të rëndësishmet në shumicë janë edhe sot, në duar të myslimanëve. Megjithëse shumica e drejtuesve ushtarakë ishin ortodoksë, ata i bindeshin verbërisht qeverisë së Tiranës nga shkak i rrezikut të shumicës myslimane, e cila përbën pothuajse shumicën e personave të së njëjtës qeveri.

Bejlerët myslimanë shpresojnë që një ditë do të jenë në gjendje të sundojnë në Shqipëri, të marrin pjesën më të madhe në pozicionet publike, të përvetësojnë sistemin e qeverisjes si në kohën e regjimit osman, duke lejuar lehtësisht zvetënimin me anë të parasë. Ata kërkojnë të shfrytëzojnë fanatizmin fetar të shumicës myslimane, së cilës i premtojnë një të ardhme të begatë, duke e bindur popullin që të përkrahi gjendjen aktuale. Nga pikëpamja ekonomike kjo situatë mund të karakterizohet shumë e rëndë. Shkaqet janë disa: si mungesa e punës, vështirësitë e komunikimit, inflacioni i pamasë i artikujve ushqimorë më të domosdoshëm, mospasja pothuajse të një tregtie të plotë me jashtë si edhe taksat e larta doganore që luhaten nga 25 deri në 100 për qind.

Fanatizmi i myslimanëve rritet nga dita në ditë dhe në qoftë se ai ende nuk ka dalë plotësisht në horizont, kjo ndodh sepse ata kanë frikë mos humbasin Shqipërinë, duke e ditur se deri tani për çështjen e kufijve nuk është vendosur përfundimisht.

Pavarësisht nga përpjekjet e bëra për t'i dëshmuar botës se janë në gjendje të qeverisin me drejtësi dhe paanësi vendin e tyre, në thelb, shqiptarët myslimanë nuk i harrojnë kurrë dëmet që u janë shkaktuar atyre nga Greqia. Ata po presin ditën që kur të jenë në gjendje të hakmerren kundër ortodoksëve, të cilëve ua ngarkojnë fajin për padrejtësitë e pësuar.

Ortodoksët në përgjithësi, domethënë më shumë shqiptarët sesa grekomanët, e kanë kundërshtuar plotësisht imazhin e një vendi me natyrë myslimane. Ata u morën vesh vetë midis tyre për të shmangur rrezikun e epërsisë myslimane.

Faktikisht tre muaj më parë në Përmet u krijua, një komitet ortodoks, i cili madje kishte formuar dhe një ushtri të vogël e quajtur "ushtria e mbrojtjes kombëtare" (ose më mirë të themi mbrojtja kundër myslimanëve).

Ortodoksët, shfaqin sot më tepër qetësi, ndoshta për shkak të frikës nga myslimanët dhe shpresojnë në ndërhyrjen e ndonjë Fuqie për t'i shpëtuar nga mbizotërimi mysliman.

Ata sot besojnë në ndërhyrjen e Italisë dhe nuk mendojnë shumë për siguri nga Greqia, për shkak se situata e saj e brendshme ishte kritike.

Njësoj sikurse ortodoksët, edhe një shumicë e popullsisë së varfër myslimane, do të dëshironte ndërhyrjen e Italisë në Shqipëri për ta shpëtuar vendin nga kushtet e vështira ekonomike, në të cilat ndodhej akoma.

Megjithatë askush nuk e kishte guximin të shprehte hapur dëshirën për ndërhyrje të Italisë. Në të vërtetë shumë deklaronin se e kritikonin ashpër

politikën që Italia ndiqte në Shqipëri. Këtë e bënin për t'i pëlqyer bejlerëve myslimanë, të cilët shpresonin se një ditë do të ishin sunduesit e Shqipërisë. Nacionalistë të vërtetë konsideroheshin ata që e përbuznin Italinë.

I njëjti Myfid bej Libohova denoncohej vazhdimisht me përbuzje dhe urrejtje publike për arsye se kishte ndjenja italofile.

Italianët që banonin në Vlorë ashtu sikurse është përmendur në raport, nuk janë trajtuar keq nga popullsia shqiptare, kjo ose sepse ata nuk shfaqin ndonjë interes për situatën politike shqiptare, ose sepse ata janë të lidhur me shqiptarët për arsye tregtie dhe biznesi.

Mirëpo të njëjtët italianë nuk ndodh që të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe nga autoritetet shqiptare.

Këto të fundit i kanë detyruar ata që të heqin nga dyqanet shkrimet dhe simbolet e shkruara në gjuhën italiane, kurse nëntorin e kaluar lejet për gjueti dhe licenca iu mohuan vetëm italianëve, megjithëse kërkoheshin vazhdimisht.

Milicia shqiptare, e krijuar gjatë periudhës së pushtimit italian, pas largimit nga Shqipëria të trupave tona, gjendet në një pozitë të shkathët dhe e organizuar në disa njësi.

Në batalionin e vendosur në Gjirokastër gjenden një toger dhe katër nëntogerë, të cilët tanimë i përkasin milicisë shqiptare. Tre prej tyre kanë dhënë dorëheqjen, ndërsa dy të tjerët kanë për ta bërë gjithashtu, sepse janë urreyer dhe trajtuar padrejtësisht nga eprorët. Shkaku ishte se megjithëse ishin të pajisur me dëshmi aftësie për gradim, nuk e morën ngritjen në pozitë, ndërkohë që njerëz të thjeshtë janë caktuar oficerë me gradë më të lartë se të tyre.

Në Vlorë kohët e fundit është vrarë Siri Beu një italoofil. Ka zëra që ai u vra pikërisht për ndjenjat e tij në favor të Italisë.

Në periodikun "Gazeta e Korçës" në numrin e saj të 67 qeveria e Tiranës kritikohet shumë, pasi që deri më sot nuk i ka dhënë popullit ndonjë lajm për rezultatet e arritura nga komisioni shqiptar që kishte shkuar në Romë. Artikulli përfundon duke shprehur dyshime për sjelljen e Italisë, duke e cilësuar atë të errët në lidhje me Shqipërinë.

Në Shqipëri, vetëm ndërmarrjet italiane nuk ekzistojnë, dhe ndonjë me pak rëndësi punon në bashkëpunim me shqiptarët.

Po bëhen përpjekje që të ndërtohet edhe një shoqëri shqiptare për të blerë 5 vaporë për shërbimin detar në Adriatik, i cili nuk shërbehet më nga italianët. Tregtia italiane në Shqipëri sot është ulur ndjeshëm dhe nga Italia gati nuk importohen më mallra.

### **Himara**

Situata në rajonin e Himarës vazhdon të jetë e pandryshuar. Kreu i bandës Çako Lape kohët e fundit është strehuar në Himarë. Ndonëse rezulton se i ashtuquajturit kreu i bandës ishte këto kohët e fundit dakord me qeverinë e Tiranës, lind dyshimi se ai, nën pretekstin e strehimit në Himarë, është dërguar

nga e njëjta qeveri për të kontrolluar çfarë po ndodh në atë rajon dhe për të planifikuar zotërimin e Himarës nga ana e trupave shqiptare.

Një person nga Himara ka njoftuar një informator të konsullatës italiane se udhëtimi i fundit i prefektit të Gjirokastrës në fshatin Piqeras kishte për qëllim të përhapte një propagandë shqiptarofile në rajonin e Himarës. Gjithashtu do të analizohej gjendja nëse ishte rasti për ta zgjeruar kufirin shqiptar deri në Qeparo dhe të ngushtohej territori i Himarës, i cili gëzonte një qeverisje administrative autonome të privilegjuar.

Javën e kaluar një anije me vela italiane u detyrua nga moti i keq që të strehohej në brigjet e Himarës në afërsi të Porto Palermos. Disa himariotë kanë plaçkitur anijen me vela dhe kanë vjedhur marinarët, të cilëve u kanë marrë edhe rrobat. Duket se për këtë ngjarje është interesuar konsulli ynë në Korfuz.

Sipas lajmeve që qarkullojnë në Gjirokastrë duket se qeveria greke subvencionon administratën autonome të Himarës me 7.000 dhrahmi çdo muaj.

### **Zgjedhjet për senator në Gjirokastrë dhe Korçë**

Në Shqipëri, zgjedhjet për në senat nuk kanë përfunduar akoma. Numri total i senatorëve do të jetë rreth 100, pra 1 për çdo 12.000 banorë.

Senatorët e rrethit të Gjirokastrës do të jenë 10 dhe po aq do të jenë dhe ata të krahinës së Korçës.

Në rajonin e Gjirokastrës, duke pasur parasysh numrin e banorëve, ortodoksëve u janë caktuar 6 poste, ndërsa myslimanëve 4.

Kandidatët nacionalistë ortodoksë të deklaruar nga komisioni janë si më poshtë:

Vasil Dilo, Pjetër Harito (për Gjirokastrën e përreth), Koço Tasi, Stavro Vinjau dhe Dhimitër Kasimburo (për Përmetin e përreth).

Një vend i lënë bosh iu është ofruar ortodoksëve të greqizuar, por këta nuk deshën ta pranonin duke thënë se nuk do marrin pjesë në betejën elektorale.

Nacionalistët ortodoksë shqiptarë do të donin të përfshinin në listën e tyre të kandidatëve për senator edhe Myfid bej Libohovën, por duket se për të bërë këtë do të duhej përkrahja e e Italisë.

Më 17 të këtij muaji në krahinën e Gjirokastrës kanë filluar zgjedhjet e shkallës së parë. Llogaritjet që zgjedhjet e shkallës së parë e dytë të përfundojnë pas 10 ditësh.

Për shkak të vështirësive të komunikimit ndërmjet disa qendrave elektorale, nuk është e mundur të kemi tani për tani të gjitha të dhënat e nevojshme për të bërë parashikime rreth rezultatit të të njëjtave zgjedhje.

Myfid bej Libohova ka pasur një shumicë të madhe në qytetin e Gjirokastrës. Vizita e bërë nga Myfid Beu në të njëjtin qytet ka pasur si efekt garantimin e një rryme të fortë përkrahësish. Popullsia e qytetit të Gjirokastrës shpreson se, duke pasur si senator Myfid bej Libohovën, ai do të ndihmonte në përmirësimin e situatës, pasi do ta vendoste Shqipërinë nën mbrojtjen e ndonjë

fuqie të madhe. Në Gjirokastrë është e njohur që Myfid Beu është një mik i Italisë.

Duke parë betejën e ashpër që organet e qeverisë së Tiranës po i bëjnë Myfid Beut në zonën e Gjirokastrës, sukcesi i tij në zgjedhjet e tanishme nuk mund të konsiderohet i sigurt.

Ortodoksët e rrethit të Gjirokastrës kishin vendosur të mos merrnin pjesë në zgjedhjet për senator. Faktikisht disa “Mühtar” ortodoks (kryetarë të komunitetit) refuzuan madje t’i binden urdhrave të qeverisë për të vazhduar zgjedhjet.

Si pasojë, prefektura e Gjirokastrës u detyrua të arrestojë 4 nga të lartpërmendurit “Mühtar” dhe 7 kryetarë ortodoksë që bënë propagandë për të bindur popullsinë të mos merrte pjesë në zgjedhje.

Patjetër kjo masë mjaftoi që zgjedhjet të zhvilloheshin edhe me konkurrimin e elementëve ortodoksë.

Të arrestuarit u liruan në ditën pasuese, por 4 “mühtar-ët” u paditën në Gjykatën Penale për moszbatim të urdhrave që iu ishin dhënë atyre nga qeveria.

Zgjedhjet për senatorë në rrethin e Korçës kanë përfunduar. U zgjodhën senatorët e mëposhtëm:

Eshref bej Frashëri, Sotir Peci, Pandeli Cale, Sejfi Vllamasi, Loni Kristo (aktualisht në Amerikë me detyrën e zëvendës-presidentit të Vatrës) Banush Hamdiu, Tefik Panariti dhe Kristaq Kirka.

Në zgjedhjet për senator elementit ortodoks i krahinës së Korçës abstenoj. Arsyet e një abstenimi të tillë janë:

1. Sepse ortodoksët e Korçës e shohin si të padrejtë caktimin e 6 vendeve për elementin mysliman ndërkohë që atij ortodoks, që përbën shumicën e popullsisë i janë caktuar vetëm katër vende;
2. Sepse të njëjtët ortodoksë janë sot kundër qeverisë së Tiranës, e cila ka treguar siç po dëshmon akoma deri më tani, dëshirën për ta bërë Shqipërinë një shtet të vogël mysliman.

### **Ushtria dhe xhandarmëria shqiptare**

Trupat e qeverisë shqiptare arrijnë sot përgjithësisht rreth 10.000 burra. Këta formojnë tre regjimente këmbësorie dhe një xhandarmërie.

Këto ditët e fundit një nënkolonel po udhëton në Shqipërinë e Mesme për rekrutimin e të rinjve të moshës nga 21 deri në 25 vjeç, të cilët i përkasin feve të ndryshme. Në ushtrinë shqiptare nuk rezulton që të ketë oficerë të kombësive të tjera. Ushtarakët janë të gjithë shqiptarë dhe sidomos eprorët, gati të gjithë kanë shërbyer në ushtrinë turke.

---

\* Kryeplak i një fshati ose i një lagjeje.

Majorit Mustafa Maksuti, komandant në batalionin e xhandarmërisë së Gjirokastrës, i është kërkuar nga qeveria e Tiranës të japi dorëheqjen duke qenë se në zgjedhjet e tanishme kishte vendosur kandidaturën e tij si senator.

Për rrjedhojë drejtimi i xhandarmërisë së Gjirokastrës iu besua kapitenit Stamati nga Përmeti. Për në Tiranë janë nisur nga Korça 250 ushtarë dhe nga Gjirokastra 150 të tillë, të hequr nga kompani të ndryshme.

Boshllëqet e mbetura në kompanitë e Korçës dhe të Gjirokastrës do të plotësohen gjithashtu me ushtarë ortodoksë, që do të regjistrohen së shpejti. Thuhet se regjistrimi i ortodoksëve do të zbatohet sa më parë, për arsye se qeveria e Tiranës mendon se një masë e tillë do të ketë për qëllim bashkimin në ushtrinë shqiptare të anëtarëve të besimeve të ndryshme dhe vëllazërimin mes tyre.

Një dekret i fundit i qeverisë së Tiranës përshkruan se oficerët që kanë mbushur moshën 45 vjeç duhet të lirohen dhe se gjithë të tjerët duhet që me radhë të kryejnë një kurs 3 mujor në Tiranë për vlerësimin e aftësive të tyre.

#### **Vizitat e komisioneve të huaja në vend**

Qeveria e Tiranës ka paralajmëruar telegrafisht autoritetet lokale të Shqipërisë për vizitat në muajin e ardhshëm të një komisioni francez dhe një komisioni amerikan, të cilët do të kontrollojnë situatën aktuale në rajon. Në të njëjtën kohë e njëjta qeveri i ka dhënë udhëzime autoriteteve të mësipërme rreth qëndrimit që duhet të mbajnë përpara komisioneve dhe kur duhet t'ia bëjnë të ditur këtë gjë këtyre komisioneve.

Prefekti i Gjirokastrës është lajmëruar nga qeveria shqiptare se në Shqipëri po vjen një komision anglez i përbërë nga 5 anëtar ndër të cilët deputeti Herbert dhe zoti Eden. Ky i fundit ka qenë në Shqipëri edhe gjatë luftës. Edhe komisioni anglez ka për detyrë të shikojë dhe të vlerësojë kushtet aktuale të Shqipërisë.

Sipas një telegrami të qeverisë së Tiranës drejtuar prefektit të Gjirokastrës në kryeqytet pritej ardhja edhe e dy konsujve, njëri francez dhe tjetri anglez.

Ky lajm ka shkaktuar përshtypje të mira ndërmjet qarqeve të ndryshme nacionaliste shqiptare meqenëse ardhja në Shqipëri e konsujve të lartpërmendur është një shenjë e sigurt e njohjes së shtetit shqiptar nga ana e Francës dhe e Anglisë.

Shkëlqesisë Suaj  
Senatori Konti Karlo SFORCA  
Ministër i Punëve të Jashtme  
Romë